



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2024:088921

Datë: 10.12.2024

Numri i dokumentit: 06578399

P.nr.54/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtores Profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurës F B nga rruga „V G nr. në K, për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.284/2024 të datës 20.03.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me dt.18.11.2024, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i Shtetit Ramiz Buzhala dhe e pandehura F B me dt.18.11.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 10.12.2024, e përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

E pandehura F B nga i ati F, e ëma Sh e gjinisë H, e lindur me datë në P, tani me banim rruga„V G nr në K, me nr.personal , ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë, e pamartuar, e gjendjes së dobët ekonomike, më parë e pagjykuar, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTORE

SEPSE:Me datë rreth orës minuta në K, në shkollën fillore„ M Q,, me dashje dhe në bashkëveprim edhe me të miturat F.B dhe E.B, përdoren forcën ndaj personit tjetër dhe atë ndaj të dëmtuarës D K, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje në mes djalit të dëmtuarës të moshës dhe motrës së të pandehurës gjithashtu e moshës vjeqare, me datën e lartcekur gjersa e dëmtuara e dërgon djalin e saj në shkollë aty takohet me të

pandehurën, e cila fillimisht e ofendon me fjalë të ndryshme të dëmtuarën, e më pas edhe e sulmonë duke e kap për flokë dhe duke e godit me grushta, mirëpo të njëjtës nuk i shkakton lëndime trupore.

- me çka ka kryer veprë penale, Sulmi,, nga neni 184 par. 1 të KPRK-së. Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69,70 dhe nenit 184 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 463 të KPPRK-së:

### GJYKON

### DËNIM ME KUSHT

Të pandehurën: F B me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë ( 6 ) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.

Në të kundërtën nëse e pandehura brenda periudhës së lartëcekur të verifikimit kryen veprë tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 par.2 dhe 3 të KPRK-së, do ta revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të shqiptohet dënim unik për veprën penale të kryer më parë dhe veprën penale të re.

DETYROHET e pandehura që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20 Euro) si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro ( 20 euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

UDHËZOHET pala e dëmtuar, D K nga rruga afër Stacionit Policor në K, që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest të rregullt civil.

### A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.284/2024 e datës 28.02.2024, kundër të pandehurës F B nga rruga „VG nr. në K, për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata me datë 18.11.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala si dhe e pandehura F B

Deklarimi i të pandehurës lidhur me pranimin e fajësisë.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.18.11.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtarja e vetme gjykuese pasi bindet se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtës i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që e pandehura F B ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të kësaj natyre apo natyrës tjetër dhe se pala e dëmtuar disa here më ka fyer me fjalë dhe për këtë arsye jamë detyruar që ta sulmoj.

Deklarimi i palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij, pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me nenin 242 par.2 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merre si rrethanë lehtësuese, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese i ka propozuar gjykatës që të merr parasysh intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjësisë penale.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga e pandehura, nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga e njëjta, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale, të cilat mbështesin aktakuzën, si : raporti i oficerit policor A K #0845 i dt.02.02.2024, Raporti i oficerit EBi dt.03.02.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarën i dt.03.02.2024, Procesverbali i marrjes

në pyetje të dyshueren Fortesa Bajrami e dt.03.02.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarën EB e dt.03.02.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje F B i dt.03.02.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje dëshmitarin G A i dt.06.02.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje dëshmitaren D Sh i dt.06.02.2024.

Gjendja faktike e vërtetuar:

Bazuar në të lartëcekurat gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se e pandehura me dashje ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Ne nenin 184 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen,, Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1 ) vit. ,,

Andaj bazuar në të lartëcekura, gjykata ka vendosur që të pandehuren ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale,, Sulmi,, nga neni 184 par.1 të KPRK-së, nga se veprimet e të njëjtës përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është penalisht përgjegjëse.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehures bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së duke e vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, padënueshmërinë, nga ana e të pandehures, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrehana rënduese sa i përket të pandehurës Gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjësis penale.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurës do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsistot në parandalimin e të njëjtit nga kryerje e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 nën par.2.6 të KPPK-së.

Vendimi për taksën për kompensimin e viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 par.1 pika 1.5 dhe nenin 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-36 për Kompensimin e viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar në arsyet e lartëcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.54/2024 me datë 10.12.2024

Gjyqtarja

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.